

VENDIM
Nr. 110, datë 2.7.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SOLARIS POWER” SHPK, PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 86, DATË 12.5.2020 “MBI REFUZIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË ‘SOLARIS POWER’ SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 52, pika 3 dhe nenit 92, pikat 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 16, pika 2, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Regullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 78/2 prot., datë 26.6.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Solaris Power’” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 48, datë 24.3.2020, vendosi: fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas marrjes së këtij vendimi, të ndodhur dhe në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga përhapja e virusit COVID-19, si dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë, në datën 31.3.2020, Shoqërisë i është dërguar me *email* (në adresën që rezultonte nga ekstrakti historik i QKB-së i depozituar në ERE së bashku me dosjen e aplikimit) shkresa për njoftimin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s sipërcituar, si dhe kërkesa për depozitimin e dokumentacionit të munguar apo informacionit shtesë.

- Shoqëria nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk e ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar brenda afatit të përcaktuar për vendimarrje.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 86, datë 12.5.2020, vendosi: të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Për këtë vendimarrje shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. është njoftuar me shkresën e ERE-s nr. 447/1 prot., datë 14.5.2020 (dërguar nëpërmjet postës, në adresën e shoqërisë që rezulton në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)).

- ERE ka proceduar në vijim me ridërgimin e shkresës sipërcituar në adresën sekondare të lënë në formatin e aplikimit nga përfaqësuesi ligjor i kësaj shoqërie.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 447/2 prot., datë 28.5.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, me pretendimin se nuk e ka marrë njoftimin për fillimin e procedurës, për shkak se *email*-i i vendosur në ekstraktin historik të shoqërisë, i përket një punonjësi të larguar nga shoqëria.

- Bashkëlidhur kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 86, datë 12.5.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., ka depozituar dhe një pjesë të dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- ERE vlerëson se kërkesa e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., përmbush kushtet dhe përcaktimet ligjore, që kanë të bëjnë me legjitimitimin e palëve dhe afatin për të paraqitur një kërkesë të tillë.

- Gjatë shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë është konstatuar se nuk është plotësuar ende tërësisht dokumentacioni i kërkuar për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ndaj ERE-s i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 447/3 prot., datë 11.6.2002, duke i kërkuar që të depozitojë dokumentacionin e munguar.

- Me shkresën nr. 447/4 prot., datë 19.6.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k., ka kërkuar zgjatjen e afatit me 10 ditë të tjera për depozitimin e këtij dokumentacioni.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë ‘Solaris Power’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti